

E nderuar zonja drejtuese e seancës, Të nderuar deputetë, Të nderuar qytetarë, Sot kam nderin të flas para jush në cilësinë e relatores të Komisionit për Ekonominë dhe Financat për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e huamarrësit, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main për rehabilitimin me eficiencë energjetike të konvikteve studentore të universiteteve publike në Shqipëri në shumën prej 20 milionë eurosh”. Baza e kësaj marrëveshjeje huaje është nota verbale për bashkëpunimin financiar e datës 9 maj 2019, drejtuar qeverisë së Republikës së Shqipërisë nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë. Sipas marrëveshjes, KfW-ja do ta rifinancojë huan e dhënë, në përputhje me kushtet e kësaj marrëveshjeje, me subvencion interesi nga fondet e buxhetit me interes të ulët të ofruar nga Republika Federale e Gjermanisë për projektet që plotësojnë kriteret e zhvillimit dhe të politikës. Termat dhe kushtet e huas janë në përputhje me kërkesat e OECD-së të zbatueshme në datën e nënshkrimit të marrëveshjes për njohje si asistencë zyrtare për zhvillim. Për të plotësuar fondet e ofruara nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, Komisioni Europian ka vënë në dispozicion përmes KfW-së fonde shtesë sipas kuadrit të investimeve për Ballkanin Perëndimor (KIBP). Si rrjedhojë, KfW-ja dhe huamarrësi synojnë të lidhin një marrëveshje të veçantë granti deri në shumën 4,785,067 euro për financimin e pjesshëm të projektit.

Projektligji përbëhet nga 2 nene gjithsej. Në nenin 1 parashikohet ratifikimi i marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për rehabilitimin me eficiencë energjetike të konvikteve studentore të universiteteve publike në Shqipëri. Në nenin 2 parashikohen dispozitat e hyrjes në fuqi. Për sa u takon efekteve financiare të marrëveshjes së huas, më lejoni të paraqes shkurtimisht disa nga treguesit më kryesorë që lidhen me të: Shuma e huas 20 000 000 euro; interesi i përcaktueshëm në momentin e disbursimit: norma bazë ICAPEURO + 0,55% marzhi fiks; tarifa e manaxhimit: 1% e shumës së huas; komision angazhimi 0,25 % në vit; maturimi 15 vjet, duke përfshirë periudhën prej 5 vjetësh, pa pagesë principali. Nëse flasim për rëndësinë e këtij programi, dua ta vendos theksin në rehabilitimin me eficiencë energjetike të konvikteve studentore të universiteteve publike në Shqipëri, si dhe ndërtimin e disa konvikteve të reja. Synimi i programit është që, nëpërmjet aplikimit të masave të eficiencës së energjisë, të kursehet ndjeshëm energjia në godinat e rehabilituara, njëkohësisht, t’u sigurohen studentëve kushte jetese të përshtatshme dhe kosto të arsyeshme akomodimi në godinat e konvikteve. Ky program është vijim i zbatimit të konsultimeve qeveritare midis Republikës Federale Gjermane dhe Republikës së Shqipërisë të vitit 2017. Aktualisht, janë në fazë zbatimi marrëveshjet përkatëse të financimit për fazën I përmes grantit në vlerën 4,7 milionë euro, për fazën II në vlerën 2,9 milionë euro dhe fazën III 2 milionë euro të lidhura me KfW-në. Nga KfW-ja janë financuar 738 milionë euro të dedikuara për projekte investimi në fushën e energjisë dhe infrastrukturës.

Ky program do të vijojë me të gjitha godinat studentore në vend dhe kjo kredi do të shkojë për rehabilitimin e godinave dhe ndërtimin e godinave të reja, ku pjesë përbërëse është edhe efienca e energjisë. Aktualisht nga KfW-ja janë financuar 19 godina dhe ka përfunduar auditimi i 5 godinave të para. Janë rreth 5000 studentë që do të përfitojnë nga ky projekt, ndërkohë që kapaciteti i studenteve për akomodim në total në këto godina është 5700. Më konkretisht, shumën e akorduar në formën e huas, përmes kësaj marrëveshjeje, do të shërbejë për rehabilitimin e konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të eficiencës së energjisë, faza IV. Gjithashtu, një pjesë e huas do të përdoret për ndërtimin e disa godinave të reja nga masterplani i “Qytetit Studenti 1” te Rruga e Elbasanit në vlerën

35 milionë euro dhe ka subjekt rehabilitimin e 19 godinave dhe ndërtimin e minimumit 3 godina me performancë afër zero energji, të cilat pas rikonstruksionit pritet të akomodojnë rreth 3200 studentë dhe pjesa tjetër e akomodimit do të plotësohet nga buxheti i shtetit. Kredia parashikohet të disbursohet në një periudhë maksimale prej 5 vjetësh dhe disbursimi i plotë i kredisë do të jepte impakt në nivelin e borxhit kundrejt PBB-së me rreth +0.11% deri në +0.12%, në varësi edhe të nivelit të produktit të brendshëm bruto për vitet në vijim. Ndërkohë, nuk pritet të ketë impakt në nivelin e borxhit publik për vitin 2022, pasi gjatë këtij viti nuk ka pritshmëri që të disbursohet një pjesë e konsiderueshme e saj. Për sa i përket buxhetit dhe nëse është e parashikuar në të kjo kredi, sqarohet se pa dyshim që është e parashikuar dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë është e angazhuar maksimalisht që ligji organik i buxhetit 2022 të respektohet dhe në vitin e ardhshëm borxhi publik të jetë minimalisht 1 pikë më i ulët se sa borxhi i vitit 2021. Lidhur me kërkesat për një raportim më konkret se ku kanë shkuar paratë e tri fazave të para, si janë investuar këto nëpër konviktet shqiptare dhe sa ka qenë rentabël ky investim, do t'u lutesha kolegëve deputetë të opozitës të kishin durimin dhe të ishin prezentë në mbledhjen e Komisionit të Edukimit dhe Arsimit, pasi ata e braktisën sallën, dhe do të informoheshin se nga ana e Ministrisë së Financave u përcoll te Komisioni i Ekonomisë dhe Financave një informacion i detajuar në formë tabelore me fondet e projektit, ku janë përcaktuar të gjithë kontribuuesit. Deri në fund të dhjetorit 2021 janë disbursuar për agjentin e tenderit dhe konsulentin e projektit 216 milionë euro.

Pra, disbursimi është rreth 0,021% e buxhetit total të fazave I, II dhe III, pa përfshirë fazën IV. Gjithashtu, projekti operon me disbursim indirekt, që do të thotë se fondet ndodhen pranë KfW-së dhe, në bazë të realizimit të projektit, ato do të disbursohen duke marrë miratimin "noobjection". Vetëm pjesa e TVSH-së (kontribut i buxhetit të shtetit) është e parashikuar në PBA, e cila do të disbursohet sipas ecurisë së realizimit të projektit. Duke evidentuar qartësisht faktin se ky projektligj është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe duke vlerësuar se ratifikimi i kësaj marrëveshjeje do të mundësojë rehabilitimin energjetik të konvikteve përmes aplikimit të masave të eficiencës së energjisë dhe ndërtimin e disa konvikteve të reja, duke sjellë kështu përmirësim të kushteve të jetesës së studentëve, në kuadër edhe të Paktit për Universitet, ftoj kolegët deputetë të maxhorancës dhe të opozitës ta votojmë atë. Faleminderit!